

NJOFTIM PËR TAKIM PUBLIK “ONLINE”

Raporti gjashtëmuor i kryetarit të komunës

Datë: 03 gusht, Ora: 14:00 – 16:00

Kryetari i Komunës së Kamenicës, z. Qëndron Kastrati fton të gjithë qytetarët në diskutimin e hapur publik i cili do të mbahet “online” me qëllim informimin e qytetarëve mbi aktivitetet e komunës në gjashtëmuorin e parë të vitit 2020. Pra, për shkak të situatës së pandemisë të shkaktuar nga COVID-19, ky takim publik do të mbahet “online” përmes platformës **ZOOM**.

1. Nëse e keni të instaluar aplikacionin ZOOM, atëherë klikoni në këtë link: <https://us02web.zoom.us/j/81112188598> apo;
2. Nëse lidheni përmes browserit (preferohet Google Chrome), atëherë klikoni këtë link: <https://zoom.us/join> dhe vendoseni këtë numër: **811 1218 8598**.

Mirëpo, nëse nuk e keni aplikacionin ZOOM të instaluar, atëherë për të shkarkuar dhe instaluar ZOOM në pajisjet tuaja, në vijim janë listuar llojet e pajisjeve dhe mënyrat e instalimit të ZOOM:

- Kompjuter, duke shkarkuar aplikacionin ZOOM përmes linkut në vijim <https://zoom.us/client/latest/ZoomInstaller.exe> dhe pastaj aplikacioni i shkarkuar të hapet për ta instaluar atë.
- Telefon me Android apo Apple iOS, duke hapur PLAY STORE/APP STORE dhe pastaj tek hapësira për kërkim (Search) të kërkohet aplikacioni “*ZOOM Cloud Meetings*”. Pasi të instalohet aplikacioni në telefonin tuaj, qasja në takim bëhet duke vendosur numrin identifikues të shënuar më lartë.

Përveç informimit, qytetarët do të kenë mundësi të shtrojnë pyetje dhe të japin propozime për kryetarin dhe kabinetin e tij.

Organizimi i takimit “online” mbështetet nga projekti DEMOS në Prishtinë.

Faleminderit